

## Jemi në luftë! (6:10–12)

**B**illi, një shoku im, është polic. Në nëntor të vitit 1994, Billi dhe disa policë të tjerë kryen një aksion në Fort Worth, Teksas. Gjatë shkëmbimit të zjarrit, Billi u plagos në këmbë. Plumbi preku një arterie dhe Billi gati sa nuk vdiq nga hemorragjia. Por, falë Zotit, ai arriti të mbi- jetonte!

Përleshja e Billit me vdekjen më sjell në mend një film policor që e kam parë vite më parë. Në njërën nga skenat një polic qëndron në spital pranë krevatit ku ndodhet kolegu i tij, i cili është plagosur për vdekje. Gruaja e policit të plagosur është atje dhe duke hedhur vështrimin nga polici, me lot në sy, i thotë: «Kurrë nuk e kisha vënë re më parë.... Kurrë nuk e kisha kuptuar më parë. Bëhet luftë, apo jo?»

Ndërsa Pali e përfundon letrën drejtuar kristianëve në Efes, ai bën pothuajse të njëjtin pohim lidhur me jetën kristiane: «Është luftë». Ai na bëri të ditur se nuk është e lehtë të jetosh jetën kristiane. Kristianizmi është një përpjekje, një betejë, «një luftë për të arritur finishin».

Asnjëri prej nesh nuk mund ta fitojë i vetëm këtë betejë të mbinatyrshme. E vetmja mënyrë për të fituar është të luftojmë me fuqinë dhe armët që na jep Perëndia:

Për çfarë mbetet, vëllezërit e mi, forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së tij. Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër kurtheve të djallit, sepse beteja jonë nuk është kundër jakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushtete-ve, kundër sunduesve të botës së errësirës

të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore (6:10–12).

Fjalët e Palit na japin këtë të vërtetë të për- jetshme: *Kristianët e fitojnë luftën kundër Satanit kur zbatojnë planin e Perëndisë për betejë.*

### **PËR TË FITUAR LUFTËN NEVOJITET PËRGATITJE PËR LUFTË**

Burimi për fuqinë që na nevojitet në luftën shpirtërore nuk gjendet në ne, por vjen nga Perëndia. Pali tha: «Forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së tij.»<sup>1</sup> Pali nuk na thotë të sillemi si «trima» apo të tregojmë fuqinë tonë. Pali na bën thirrje të marrim fuqi prej të vetmit burim të mundshëm në mënyrë që të përballojmë veprat e këqija dhe të djallëzuara të djallit. Për ta thënë më thjeshtë, nuk kemi shpresë pa fuqinë e Perëndisë.

Me fuqinë e Perëndisë kemi tamam atë fuqi që na nevojitet për të fituar luftën. Pali foli për forcën e pabesueshme që kemi për shkak të fuqisë së Perëndisë. Në kapitullin 1 Pali përmendi «madhësh- ti-në e jashtëzakonshme të fuqisë së tij ndaj nesh, që besojmë sipas veprimit të forcës së fuqisë së tij, të cilën e vuri në veprim në Krishtin duke e ringjallur prej së vdekurish» (1:19–20a). Fuqia që ringjalli Jezusin është në dispozicion të çdo kristiani.

E gjejmë atë fuqi në Fjalën e Perëndisë, kur e lexojmë atë dhe kur e zbatojmë në jetën tonë. Perëndia e vë fuqinë e Tij në dispozicionin tonë kur i drejtohem Atij me lutje. E zbulojmë fuqinë e

Perëndisë edhe kur e adhurojmë Atë. Perëndia na përcjell fuqinë e Tij edhe nëpërmjet influencës, shembullit dhe inkurajimit që na japin vëllezërit dhe motrat tona në Krisht. Çdo ditë të jetës sonë duhet të përgatitemi për betejë duke përdorur fuqinë e Tij.

Pali na tregoi me hollësi se si ta përdorim fuqinë që na ofron Perëndia: «Vishni gjithë armatimin e Perëndisë» (6:11a). Pali përshkroi, në kuptimin shpirtëror, figurën e një ushtari të pajisur me gjithë armatimin e nevojshëm, gati për betejë për të luftuar armikun. Te 6:13–20, ai dha një përshkrim të hollësishëm të armatimit.

Pali dha urdhërin për të veshur armatimin. Vini re se sa urgjente tingëllojnë këto fjalë. Po të kishte mundësi ai do të vinte te ne e do të na thoshte: «Vishni armatimin. Etër, vishni armatimin që të luftoni për familjet tuaja. Nëna, vishni armatimin. Adoleshentë, vishni armatimin në mënyrë që djalli të mos ketë mundësi t’ju mposhtë. Ju, kristianë të rritur, vishni armatimin. Mos pushoni së luftuari. Beteja nuk ka mbaruar. Vishni armatimin e Perëndisë.»

Pali e përcaktoi qëllimin e betejës me këto fjalë: «Që të mund të qëndroni kundër kurtheve të djallit» (6:11b). Droga, alkooli, pornografia dhe bixhozi nuk janë armiqtë tanë kryesorë. Ato janë thjesht armë të përdorura nga kundërshtari ynë i vërtetë. Armiku që vjen te ne me gjithë forcat e tij është i fuqishëm. Ne nuk mund ta përballojmë sulmin e ashpër të djallit pa ndihmën e Perëndisë. Djalli është mbinjerëzor, i aftë, dinak dhe me një mendje të shkathët. E vetmja shpresë që njeriu ka për të luftuar djallin e për të fituar është nëpërmjet Jezusit. Asnjë njeri nuk mund të fitojë luftën kundër djallit pa ndihmën e Perëndisë në Jezusin. Perëndia na jep fuqinë e Tij dhe armatimin e Tij, të cilat janë e vetmja shpresë për të fituar luftën kundër djallit.

Para se të nisin betejën, ushtarët kanë nevojë për një plan luftimi. Pali na ka dhënë një plan beteje, ku na tregon për përgatitjet që duhet të bëjmë. Neglizhimi i fuqisë së Perëndisë apo dështimi për të veshur armatimin e Perëndisë janë vetëvrasje shpirtërore. Kristianët që përpiqen të jetojnë pa ndihmën dhe armatimin e Perëndisë nuk mund të mbijetojnë. Mos e lejoni veten dhe familjen tuaj të jeni viktima. «Forcohuni në Zotin,... Vishni gjithë armatimin e Perëndisë.» Përgatituni për betejën duke shfrytëzuar çdo burim shpirtëror që ju ofron

Perëndia. Është shpresa juaj e vetme!

## **PËR TË FITUAR LUFTËN DUHET NJOHUR ARMIKU**

Të përpiqesh të njohësh gjithë ç’është e mundur për armikun, para se të fillojë lufta, është një veprim i mençur. Skuadrat sportive shqyrtojnë kundërshtarët me të cilët do të luajnë në të ardhmen. Firmat mësojnë gjithë ç’ka munden për konkurentët para se të hedhin në treg një produkt të ri. Gjeneralët mbledhin sa më shumë informata që të jetë e mundur për armikun ndërsa përgatiten për betejë. Të dish sa më shumë që të jetë e mundur për kundërshtarin është një strategji vendimtare që të çon në fitore.

Pali u përpoq që t’u tregonte kristianëve se sa i fuqishëm dhe tinëzar është armiku. Pse e bëri Pali këtë? Sepse në qoftë se dalim përballë djallit të papërgatitur ose në qoftë se shkojmë në betejë pa asnjë armë tjetër, përveç fuqisë sonë të dobët, djalli do na shkatërrojë.

Pali dha tre fakte lidhur me armikun. *Së pari, armiku ynë është i fuqishëm.* Në vargun 12 thuhet: «Sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës së errësirës të kësaj epoke,...» Pali e përshkroi armikun si «principata», «pushtete» dhe «sundues». Nuk e di se çfarë kishte parasysh Pali kur përdori këto fjalë, por e di se Pali i përdori ato për të tërhequr vëmendjen drejt fuqisë së jashtëzakoshme të armikut.

Bibla na tregon për këtë fuqi djallëzore. Historia e tundimit të Jezusit në shkretëtirë e konfirmon këtë [djalli i tha Jezusit se kishte fuqinë që t’i jepte Atij gjithë mbretëritë e botës (Mateu 4:8–9)]. Jezusi gjithashtu e quajti djallin «princ të kësaj bote» (Gjoni 12:31). Djalli është në mënyrë të vazhdueshme kundër Perëndisë dhe atyre që i binden Perëndisë. Pali e quajti djallin «perëndia i këtij shekulli» (2 Korintasve 4:4). Satani dhe demonët e tij verbojnë mendjet e atyre që nuk besojnë në mënyrë që ata të mos e shohin dritën e ungjillit. Pjetri e krahasoi armikun me një «luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë» (1 Pjetër 5:8). Gjoni shtoi se «e gjithë bota dergjet në ligësi» (1 Gjon 5:19). Nuk ka rrugë të mesme. Ose jetoni nën pushtetin e Zotit Jezus, ose jetoni nën pushtetin e Satanit.

Dikush mund të thotë: «Unë besoj se Jezusi e mposhti djallin dhe fitoi.» Po, është e vërtetë. Jezusi fitoi. Megjithatë, djalli dhe demonët e tij nuk e kanë

pranuar humbjen. Ata nuk janë shkatërruar akoma plotësisht dhe përfundimisht, kështu që ata mbeten të dedikuar ndaj misionit të tyre për të shkatërruar njerëzimin. Ata kanë akoma fuqi për të shkatërruar jetën e njerëzve.

*Së dyti, armiku është i lig.* Beteja jonë është «kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore» (6:12b). Vetë fuqia mund të përdoret për të bërë të mira të mëdha apo të këqija të mëdha. Armiku ynë dhe aleatët e tij e përdorin fuqinë e tyre për të shkatërruar. Ata e përdorin atë për të bërë gjëra të liga. Ata përfaqësojnë fuqitë e kësaj bote të errët. Errësira është sfera e veprimtarisë së tyre. Duke qenë të egër dhe plotësisht të këqinj, ata përpiqen me sa munden që të bëjnë kërdrinë.

*Së treti, armiku është mashtrues.* Rilexoni vargun 11. Pali flet për të qëndruarit kundër «kurtheve të djallit». Djalli nuk e prezanton veten duke thënë: «Unë jam djalli. Kam ardhur të shkatërroj jetën tënde dhe të të çoj në ferr.» Ai kurrë nuk vjen te ne në mënyrë direkte. Ai përdor mashtrimet. Ai i ka qejf gënjeshttrat. Ai kënaqet kur mashtron.

- Për të na bërë të mëkatojmë, mjeshtri i mashtrimeve — na bind se «nuk ka gjë, nuk do na ndodhë gjë»;
- na bind se asnjë nuk do e marrë vesh dhe se, sido që të jetë, Perëndia do na falë;
- na bind se ajo që po na tundojnë që të bëjmë do na sjellë kënaqësi në të vërtetë;
- minon bindjet tona shpirtërore, në mënyrë që të mos na bëjnë më përshtypje mëkatet që kryejmë;
- na bën që të lodhemi dhe të rraskapitemi në mënyrë që të kërkojmë çlodhje të menjëhershme dhe të jemi të gatshëm të bëjmë çdo gjë që do të na bëjë të çlodhemi;
- shtrembëron mendimet tona në mënyrë që të mos kuptojmë më se çfarë është e drejtë.

Armiku është mashtrues, djallëzor dhe tinëzar. Ai shndërrohet në ëngjëll drite (2 Korintasve 11:14). Metodat e tij prej eksperti përfshijnë forma të ndryshme mjeshtërie. Cila është mundësia jonë për të fituar kundër tij? Të vetëm, nuk kemi asnjë mundësi. Në qoftë se përpiqemi ta luftojmë pa Perëndinë, do të humbasim. Kjo është arsyeja se pse thirrja e Palit është aq urgjente. Kur e njohim fuqinë e armikut, e vëmë re se sa shumë kemi nevojë për Perëndinë.

Ndaloni për një moment dhe mendoni për armikun. Mendoni se sa të forta mund të jenë forcat e së keqes. Mendoni se sa ligësi ka sjellë djalli në këtë botë. Mbani mend se ai ju ka vënë në shënjestër.

Ai do t'ju shkatërrojë dhe ka fuqi që t'ju mposhtë. Mendoni se sa të këqinj janë djalli dhe toga e tij. Ata qëndrojnë kundër çdo gjëje që ka të bëjë me Perëndinë dhe përpiqen që t'ju tërheqin në anën e tyre. Ndërsa mendoni për të gjitha këto, mbani parasysh se sa mashtrues është armiku. Forcat e këqija të këtij shekulli përdorin çdo mashtrim të mundshëm për t'ju kthyer kundër Perëndisë. Duhet t'i mbajmë sytë hapur për sa i përket njohjes së armikut.

## KONKLUZION

*Kristianët e fitojnë luftën kundër djallit kur zbatojnë planin e betejës të dhënë nga Perëndia.* Ju kërkoj që të bëni dy gjëra. Së pari, shprehni në lutjet që i drejtoni Perëndisë se nuk do të luftoni të vetëm kundër djallit. Mos u përpiqni të luftoni të vetëm në betejat shpirtërore. Mos u përpiqni të mbështeteni vetëm në fuqinë tuaj.

Së dyti, shprehni në lutjet që i drejtoni Perëndisë se do të kërkonit gjithmonë fuqinë e Tij. Rrëfeni nevojën që keni për armatimin e Tij. I kërkonit Perëndisë që t'ju forcojë, që t'ju ndihmojë të vishni armatimin e Tij dhe ta përdorni atë. Kërkojini Perëndisë që t'ju kujtojë çdo ditë se jeni në luftë, në një betejë për jetë a vdekje, dhe se dëshironi të jeni në anën e fituesve, së bashku me Jezusin.

Lexoni edhe një herë fjalët e Palit.

Për çfarë mbetet, vëllezërit e mi, forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së tij. Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër kurtheve të djallit, sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesvë të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore. Prandaj merreni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund të rezistoni në ditën e mbrapshtë dhe të mbeteni më këmbë pasi të keni kryer çdo gjë (6:10–13).

A po përpiqeni të jetoni jetën pa Jezusin dhe pa fuqinë që Ai u jep kristianëve? Nuk mund të fitoni pa Jezusin. Kërkojeni Atë. Ai do të jetë fuqia juaj. Ai do të bëjë të mundur që ju t'i rezistoni djallit. Ai do të ndajë fitoren me ju.

Jezusi nuk ju detyron që të merrni atë që Ai ofron. Ai ju jep mundësinë të zgjidhni. Nuk keni nevojë të harxhoni kohën duke u përpjekur të luftoni të vetëm kundër errësirës. Kjo botë e ligë do t'ju shkatërrojë. Ju keni nevojë për Jezusin. Ai është gati t'ju marrë, por ju duhet të jeni gati t'i thoni: «Kam nevojë për ty, Jezus. Ti vdiqe për mëkatet e

mia. Dua të pagëzohem për të larë mëkatet dhe të filloj të ecë në fuqinë Tënde.»

Ndoshta, disa kristianë janë përpjekur të fitojnë betejat shpirtërore pa veshur armatimin e Perëndisë. Satani kënaqet kur kjo ndodh. Ai do që ju të mos dini asgjë për betejën shpirtërore. Kthehuni te Perëndia dhe i thoni djallit të largohet prej jush. Perëndia është i gatshëm t'ju japë fuqi. Ai e ka gati

armatimin. Ai pret që ju të merrni vendimin e duhur.

### **SHËNIME**

<sup>1</sup> Fjala greke është «endhinamóneste». Në vargun 10 kjo folje është përdorur në kohën e tashme dhe në mënyrën urdhërore që na tregon dy gjëra të rëndësishme. (1) «Forcohuni» do të thotë të forcohem vazhdimisht, pa pushim; dhe (2) është diçka që lejojmë të bëhet ndaj nesh. Nuk forcohem vetë, por e lejojmë veten të forcohet.

Autor: *Rusty Peterman*  
Marrë nga seria: “*Efesianëve*”  
© 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara